



Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
**Prezenca në Shqipëri**

**PËRGGJIGJET E KRYETARIT TË PREZENCËS PËR GAZETARËT  
LIDHUR ME SITUATËN POLITIKE NË SHQIPËRI**

*11 prill 2013*

**Si e komentoni zhvillimin e fundit lidhur me KQZ-në, për lirim të anëtarit të LSI-së?**

**Ambasadori Wollfarth:** “Prezenca e OSBE-së ka një mandat, i cili përfshin shtetin e së drejtës, si një prej çështjeve të tij themelore. Më lejoni të përqendrohem te ky aspekt. Aspektet politike varen nga kampi që i sheh këto çështje, por aspektet ligjore duhet të jenë të njëjta për të gjitha palët. Do të jetë shumë e rëndësishme të kemi shpjegime të mëtejshme lidhur me bazën ligjore mbi të cilën është marrë apo duhet të merret çdo vendim. Disa aktorë politikë, por gjithashtu edhe ekspertë ligjorë, na kanë shprehur dyshime lidhur me bazën ligjore. Prandaj, nga këndvështrimi ynë, ne do të ftonim qartas që të sqarohet baza ligjore mbi të cilën veprohet. Kjo kërkon kohë dhe, për këtë arsye, çdo vendim i mëtejshëm duhet të merret me kujdes të madh dhe, shpresoj, edhe me konsensus”.

**A mendoni se të paktën kjo lëvizje në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve do të cenojë besueshmërinë e krijuar me shumë vështirësi mes palëve politike dhe do të jetë një precedent i rëndë për transparencën e zgjedhjeve të 2013-s?**

**Ambasadori Wollfarth:** “KQZ-ja duhet të shihet si një organ teknik. Në kohën kur u zgjodhën, u emëruan dhe u miratuan nga parlamenti, ata reflektuan gjendjen e opozitës dhe të qeverisë në parlament. Kur morën detyrën, ata morën një detyrë apolitike. Sikurse thashë vetëm përpara pak ditësh: ata kanë bërë një punë shumë të mirë, edhe teknike, në kushte jo shumë të lehta, këtu në vend. Sërish, më lejoni të theksoj: do të jetë shumë, shumë e rëndësishme që të shpjegohet baza ligjore për çdo hap që ndryshon përbërjen e KQZ-së”.

**Njëra palë thotë që lëvizja ishte e ligjshme, pala tjetër thotë që ishte e paligjshme. Në mënyrën tuaj, si shpjegohet: ikja e një anëtarit të KQZ-së ishte e ligjshme apo jo? Si e lexoni ju Kodin Zgjedhor në Shqipëri?**

**Ambasadori Wollfarth:** “Nuk di të jetë bërë fakt. Ne sapo dolëm nga në një takim [i referohet takimit për bimet narkotike]. Nuk e shoh ende si fakt. Ka pasur një diskutim në një prej komisioneve, në komisionin ligjor, dje në parlament, por fjala e fundit, të paktën në dijeninë time, nuk duket të jetë thënë ende”.

**Fund**